

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbulohet “super-aplikacioni” i Rusisë që e përdori për të spiunuar qytetarët – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/zbulohet-super-aplikacioni-i-rusise-qe-e-perdori-per-te-spiunuar-qytetaret/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 11:29:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 11:29:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9e6cda44abf605cfd78234ce28f0d1508a2c19e028bfccd6b3418bcc80961c
TEKSTI	9737c89d3390d6d91c0f84c9a4ddd0403a92c3849774df8a442174aaf628e170
PAMJA	4fb2c723c47fe9aec9f41e0cb11d14b4a5bb8ef98e2d55fad57c1ebbf5f9e0a4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4fbc4692753e7ef3bacd223362e5605cc2a126483fb017a7960575c322a7a6f2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4fbc4692753e7ef3bacd223362e5605cc2a126483fb017a7960575c322a7a6f2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



për mesazhe dhe pagesa, të quajtur Max.

Autoritetet e kanë promovuar atë si një alternativë patriotike ndaj Telegram dhe WhatsApp, ndërsa figura të njohura ruse e kanë promovuar në videoklipe rap-i dhe skeçe humoristike. Këtë verë, ai u bë aplikacioni i mesazheve më i përdorur në vend.

Max është produkt i VKontakte, kompanisë ruse të rrjeteve sociale, e cila është e lidhur ngushtë me shtetin rus. Presidenti rus, Vladimir Putin, raportohet se zotëron një pjesë indirekte të Max.

Max është versioni rus i një “super-aplikacioni”, që kombinon një ekosistem shërbimesh në një platformë të vetme. Ai shërben si një hapësirë për një sërë “mini-aplikacionesh” që tashmë lehtësojnë jetën e përditshme në Rusi – aplikacione bankare, një shërbim mesazhesh që synon të zëvendësojë Telegram dhe aplikacione për shërbime thelbësore qeveritare.

“Super-app”-i më i njohur në botë është WeChat, platforma kineze që përfshin pothuajse çdo shërbim dhe që ka luajtur një rol në sistemin e kontrollit social të shtetit.

Por ndërsa WeChat u zhvillua gjatë dekadave, paralelisht me sistemin kinez të kontrollit të internetit, Max është imponuar mbi një popullsi që dikur kishte një akses kryesisht të lirë në internet.

Tani, kërkimet kanë zbuluar një pamje më të plotë të aftësive të fuqishme të Max për mbikëqyrje. Sipas Roya Ensafi, profesore e asociuar e shkencave kompjuterike në Universitetin e Michiganit, këto aftësi përbëjnë

5 “Iakovë Rusin që i hapi rrugë ngritjes së Gjykatës Speciale”, Balla akuza...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

një “derë të pasme” drejt të gjithë ekosistemit të mini-aplikacioneve në pajisjen e çdo përdoruesi.

“Ne kemi studiuar përshkallëzimin e kontrollit të internetit në Rusi gjatë dekadës së fundit”, tha Ensafi. “Ajo që ofron Max është taktika më e zgjuar, por edhe më e frikshme, që qeveritë autoritare mund të përdorin për të mbikëqyrur qytetarët e tyre.”

Ensafi e përshkroi Max si “një model që çdo qeveri mund ta ndjekë” drejt autoritarizmit dixhital.

Sipas saj, ky zhvillim përfaqëson kufirin e ri të asaj që qeveri si ato të Iranit, Kazakistanit dhe Indisë mund të përpiqen të zbatojnë në të ardhmen.

Ekipi i Ensafit arriti të shkarkonte versionin e aplikacionit që përdoret në Rusi. Studiuesit zbuluan se Max mund të marrë foto të ekranit të pajisjes së përdoruesit, përfshirë përmbajtjen e mini-aplikacioneve, pa dijeninë e tij.

Sipas tyre, aplikacioni mund të ketë akses në informacionin e ruajtur në këto mini-aplikacione, përfshirë mesazhet dhe pagesat. Ai gjithashtu mund të imitojë përdoruesit pa dijeninë e tyre.

Madje, Max mund të injektojë kod në mini-aplikacione. Kjo, sipas Ensafit, do të thotë se qeveria ruse mund ta përdorë Max për të nisur sulme kibernetike.

Hulumtimi i tyre i ka dhënë një qartësi të re debatit që po zhvillohet lidhur me aftësitë e Max për mbikëqyrje. Megjithatë, Ensafi theksoi një kufizim të rëndësishëm: Max nuk mund të depërtojë në aplikacione të veçanta si Telegram dhe WhatsApp, nëse përdoruesit i kanë të instaluar ato.

Rusia, ndërkohë, i ka ndaluar të dyja këto aplikacione.

Shumë rusë që punojnë në institucionet shtetërore ose pranë tyre janë, në praktikë, të detyruar të përdorin Max. Zyrtarë dhe punonjës të sektorit publik, studentë universitetesh, mësues dhe madje edhe nxënës shkollash janë përballur me presion për t’i zhvendosur komunikimet e tyre në këtë platformë.

Një mësuese në Moskë tha se stafi i shkollës së saj u urdhërua të kalonte në Max pas udhëzimeve nga autoritetet e qytetit.

“Drejtori i shkollës na thirri në marsin e kaluar dhe na tha drejtpërdrejt: tani e tutje, gjithçka bëhet në Max. Kjo përfshinte bisedat me prindërit, dërgimin e detyrave të shtëpisë dhe komunikime të tjera të shkollës”, tha mësuesja.

“Nuk ka vërtet mundësi të thuash jo, kështu që në fund thjesht e përdor aplikacionin”, shtoi ajo.

Ai tha se kishte shqetësime për sigurinë dhe privatësinë e aplikacionit, por mendonte se kishte pak zgjedhje nëse dëshironte të vazhdonte të kishte akses në kampus.

Mes elitës ruse, përdorimi i Max duket se është shpesh kryesisht demonstrativ, ndërsa Telegram dhe Signal vazhdojnë të përdoren gjerësisht për komunikimin e përditshëm, sipas disa personave me lidhje të forta politike dhe biznesmenëve të njohur.

Një person nga rrethi i brendshëm i Kremlinit tha se ai dhe disa miq të tij

kishin blerë telefona të dytë vetëm për të instaluar Max, ndërsa vazhdonin të përdornin pajisjet kryesore dhe aplikacionet e tyre të preferuara të mesazheve si më parë.

“E gjithë kjo është për shfaqje. Askush në politikë nuk e përdor realisht”, tha personi, duke folur në kushte anonimiteti.

Max ende nuk e ka zëvendësuar Telegram si një burim kryesor lajmesh për rusët. Kanalet publike – të përdorura nga mediat, blogerët dhe zyrtarët për të shpërndarë lajme dhe komente te audienca të mëdha mbeten shumë më pak të zhvilluara në Max, ku vetëm një numër i vogël kanalesh kanë krijuar audienca të krahasueshme me kanalet më të mëdha në Telegram.

Disa përdorues të Max të kontaktuar nga “The Guardian” thanë se aplikacioni i ngjan shumë Telegramit në dizajn dhe funksionalitet, por shqetësimet për privatësinë dhe mbikëqyrjen janë të përhapura.

“Të përdorësh Max të jep ndjesinë se nuk e di kurrë plotësisht se kush tjetër mund të jetë duke të parë”, tha Nikolai, një konsulent 34-vjeçar nga Moska.

Ai tha se aplikacioni dukej modern dhe i kuruar, por gjithmonë ekzistonte diçka paksa shqetësuese në përdorimin e tij.

“Përfundon duke e përdorur gjithnjë e më shumë, sepse alternativat po bëhen gjithnjë e më të vështira për t’u aksesuar. Por ende nuk të duket si diçka e drejtë”.

Suksesi i Rusisë në përhapjen e shpejtë të Max duhet të shërbejë si një “sinjal alarmi”, tha Ensafi.

Kina arriti gjendjen e saj aktuale të autoritarizmit dixhital gjatë një periudhe prej 35 vitesh. Rusia, megjithatë, i ka vendosur këto kufizime gjithëpërfshirëse duke i drejtuar njerëzit drejt një interneti të kontrolluar nga shteti brenda vetëm një dekade.

“Bota po ndryshon, infrastruktura e komunikimit privat po ndryshon dhe sulmi i qeverive autoritare është shumë agresiv”, tha ajo.

Max dhe VKontakte u kontaktuan për koment, por nuk kishin dhënë një përgjigje.



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

BOTA

Sulm fatal nga peshkaqeni në...

Xhuljana Zhuleku 30 minuta më parë

BOTA

Tragjedi në Athinë, 3 të rinj shqiptarë...

Xhuljana Zhuleku 2 orë më parë

BOTA

Deputeti mbetet i bllokuar në tualetin ...

Xhuljana Zhuleku 2 orë më parë

Lini një koment

komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.